



Prishtinë, 10 shtator 2010
Kodi i ZRRE-së: V_293_2010

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna në Nenin 15 Paragrafi 2 dhe Nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-080;
2. Dispozitat e Nenit 6 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit (OST),
3. Kërkesën e KOSTT Sh.a të datës 12.08.2010 për aprovimin e dokumentit **“Plani Zhvillimor i Transmisionit 2010 – 2019”**,

Në seancën e mbajtur me datë 10 shtator 2010, nxori këtë:

VENDIM

I. APROVOHET dokumenti “Plani Zhvillimor i Transmisionit 2010 – 2019”, (si në SHTOJCË të këtij vendimi).

Arsyetim

1. KOSTT Sh.A ka përgatitur dokumentin Plani Zhvillimor i Transmisionit 2010-2019 dhe e ka dorëzuar në ZRRE për komentim. Pas dhënies së komenteve nga ZRRE, KOSTT e ka dorëzuar këtë plan për aprovim, duke përfshirë edhe komentet e ZRRE-së të dhëna në disa faza.
 2. ZRRE me datë 12.08.2010 ka pranuar kërkesën nga KOSTT Sh.A për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit “Plani Zhvillimor i Transmisionit 2010 – 2019”.
 3. ZRRE pas vlerësimit përfundimtar të këtij plani, dhe duke marrë parasysh dispozitat ligjore të theksuara në hyrje të këtij vendimi, Bordi ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III.** Vendimi hyn në fuqi datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
- IV.** Nga data e pranimit të këtij vendimi apo publikimit të tij në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, KOSTT-i duhet të publikojë menjëherë në faqen e vet elektronike versionin e aprovuar të dokumentit “Plani Zhvillimor i Transmisionit 2010 – 2019”.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund t’i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

SHTOJCË: “Plani Zhvillimor i Transmisionit 2010 – 2019”.

Bordi i ZRRE-së:

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Theranda Beqiri, anëtare

Blerim Koci, anëtar

